

VENDIM
Nr.647, datë 20.12.1999

**PËR DHËNIE FONDI MINISTRISË SË PUSHTETIT LOKAL, PËR BLERJEN E GODINËS
SË ISH-HOTEL “DRINIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998, “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Pushtetit lokal, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 18 060 000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë mijë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për blerjen e godinës së ish-hotel “Drinit”.

2.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta